# FLETORJA ZYRTARE
# E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË


**Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare**
www.legjislacionishqiptar.gov.al

**Nr.138 19 dhjetor 2006**


P Ë R M B A J T J A


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Aktnormativ nr.2, datë 27.11.2006 | Për disa ndryshime në ligjin nr.9464, datë 28.12.2005 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006", të ndryshuar…………………… | 5459 |
| Vendim i KM nr.805, datë 6.12.2006 | Për disa ndryshime në vendimin nr.527, datë 2.8.2006 të Këshillit të Ministrave "Për emërimin në detyrë të tre anëtarëve të Entit Rregullator të Ujit (ERRU)"………………………………… | 5468 |
| Vendim i KM nr.807, datë 6.12.2006 | Për ristrukturimin e Institutit të Studimeve dhe Projektimeve të Industrisë së Lehtë……………………………………………………… | 5468 |
| Vendim i KM nr.814, datë 15.12.2006 | Për asistencën ekonomike të menjëhershme për personat që përfitojnë pension………………………………………………………. | 5469 |
| Vendim i KM nr.815, datë 15.12.2006 | Për një ndryshim në vendimin nr.434, datë 28.6.2006 të Këshillit të Ministrave "Për fondin e veçantë në institucionet buxhetore"…………………………………………………………… …….. | 5470 |

**AKTNORMATIV**
**Nr.2, datë 27.11.2006**

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9464, DATË 28.12.2005 "PËR BUXHETIN E SHTETIT TË VITIT 2006", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutes, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr.9464, datë 28.12.2005 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006", të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Neni 1

Buxheti i Shtetit, për vitin 2006, është:

| | | |
|---|---|---|
| Të ardhurat | 229 932 | milionë lekë; |
| Shpenzimet | 266 951 | milionë lekë; |
| Deficiti | 37019 | milionë lekë. |

Buxheti i Shtetit përbëhet nga fondi i konsoliduar, buxheti i sigurimeve shoqërore dhe buxheti i sigurimeve shëndetësore.".

Neni 2

Neni 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Neni 2

A. Fondi i konsoliduar, për vitin 2006, është:

| | | |
|---|---|---|
| Të ardhurat | 192 632 | milionë lekë; |
| Shpenzimet | 229 651 | milionë lekë; |
| Deficiti | 37 019 | milionë lekë; |

Fondi i konsoliduar përbëhet:

A.1 Buxheti qendror:

Të ardhurat 181 532milionë lekë;
Shpenzimet 218 551milionë lekë;

A.2 Buxheti i pushtetit vendor:

Të ardhurat 23 100 milionë lekë;
Nga të cilat:

| | | |
|---|---|---|
| Granti i pakushtëzuar nga buxheti qendror | 8 300 | milionë lekë; |
| Granti për investime nga buxheti qendror | 3 700 | milionë lekë; |
| Shpenzimet | 23 100 | milionë lekë.". |

Neni 3

Neni 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 6

Të ardhurat e fondit të konsoliduar, sipas grupeve kryesore, janë:

| | | |
|---|---|---|
| Grantet | 6 000 | milionë lekë; |
| Të ardhurat tatimore | 159 000 | milionë lekë; |
| Të ardhurat jotatimore | 16 532 | milionë lekë; |
| Të ardhurat e buxhetit vendor | 11 100 | milionë lekë.”. |

Neni 4

Neni 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 7

Kufiri i financimit të deficitit të Buxhetit të Shtetit nga burime të brendshme është 26 797 milionë lekë, nga i cili 4 000 milionë lekë financohen nga të ardhurat e privatizimit.

Në rast mosrealizimi të të ardhurave të buxhetit dhe të të ardhurave nga privatizimi, huamarrja për financimin e deficitit të brendshëm prej 22 797 milionë lekësh, nuk ndryshon. Këshilli i Ministrave merr masa për kompensimin e diferencave nga burime suplementare ose nga shkurtimi i shpenzimeve.

Kufiri neto i financimit nga burime të huaja është 10 222 milionë lekë. Ky kufi mund të ndryshojë gjatë vitit, brenda limiteve të përcaktuara në nenin 16 të këtij ligji.”.

Neni 5

Neni 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 8

Shpenzimet e fondit të konsoliduar, sipas drejtimeve kryesore, janë:

| | | |
|---|---|---|
| Shpenzimet korrente | 163 288 | milionë lekë; |
| Shpenzimet kapitale | 60 963 | milionë lekë; |
| Rezerva e Këshillit të Ministrave | 2 000 | milionë lekë; |
| Kontingjenca | 3 400 | milionë lekë. |

Kufiri i shpenzimeve për ministritë dhe institucionet, i ndarë në fonde, të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara, është sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij ligji. Për institucionet e pavarura nga Këshilli i Ministrave, kufiri i shpenzimeve, numri i punonjësve dhe fondi i pagave është sipas tabelës 1/1, që i bashkëlidhet këtij ligji. Këshilli i Ministrave vendos norma dhe standarde financiare për shpenzimet operative, të cilat janë të detyrueshme për t’u zbatuar nga të gjitha institucionet buxhetore, në varësi ose jo të Këshillit të Ministrave, si dhe për organet e pushtetit vendor. Shpenzimet e pakryera në fund të vitit buxhetor të transferohen në një llogari speciale si transfertë kapitale për t’u përdorur për shpronësimet.”.

Neni 6

Neni 12 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 12

Fondi i kontingjencës prej 3 400 milionë lekësh të përdoret: 2 000 milionë lekë, tërësisht ose pjesërisht, për uljen e deficitit dhe 1 400 milionë lekë, me vendim të Keshillit të Ministrave, për detyrimet e ndërsjella të ndërmarrjeve publike. Përdorimi i fondit prej 2 000 milionë lekësh, tërësisht për këtë qëllim, bëhet kur të ardhurat nga burimet e brendshme realizohen sa janë parashikuar në buxhet. Përdorimi pjesërisht bëhet për diferencën ndërmjet fondit të kontigjencës dhe mosrealizimit të

të ardhurave, kur mosrealizimi është më i vogël se 2 000 milionë lekë.

Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave prej 2 000 milionë lekësh përdoret për raste të paparashikuara me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 7

Neni 13 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 13

Buxheti i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë është 897 milionë lekë, nga të cilat 175 milionë lekë investime. Detajimi i fondeve buxhetore bëhet nga Kuvendi në zbatim të ligjit për statusin e deputetit dhe të rregullores së Kuvendit.”.

Neni 8

Në fund të paragrafit të katërt të nenit 15, shtohet një fjali, me këtë përmbajtje:

“Ministri i Financave ndryshon totalin e fondeve, sipas qarqeve/bashkive, në përputhje me nivelin e realizimit të investimeve.”.

Neni 9

Në përmbajtjen e neneve 8 e 11, tabelat nr.1, nr.1/1 dhe nr.2 zëvendësohen, përkatësisht, me tabelat nr.l, nr.1/1, dhe nr.2, që i bashkëlidhen këtij akti normativ.

Neni 10

Ky aktnormativ ka fuqinë e ligjit dhe hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

Tab.1 **ne 000/Leke**

| **Kodmin** | **Buxheti i vitit 2006 sipas Ministrive dhe Institucioneve (ne mije Leke)** | **Fonde te pakushtezuara** | **Fonde te kushtezuara** | **Totali** |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Presidenca | 144,000 | 0 | 144,000 |
| 2 | Kuvendi | 897,000 | 0 | 897,000 |
| 3 | Keshilli Ministrave | 562,537 | 500,000 | 1,062,537 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 4 | Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes | 1,033,400 | 3,647,100 | 4,680,500 |
| 5 | Ministria e Bujqesise, Ushqimit dhe Mrojtjes se Konsumatorit. | 3,423,584 | 1,785,050 | 5,208,634 |
| 6 | Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit | 27,331,940 | 7,170,560 | 34,502,500 |
| 9 | Regjistrimi i Pasurive te Paluajtshme | 121,000 | 219,000 | 340,000 |
| 10 | Ministria e Financave | 682,500 | 23,460 | 705,960 |
| 11 | Ministria e Arsimit dhe Shkences | 23,202,899 | 2,742,410 | 25,945,309 |
| 12 | Ministria e Turizmit, Kultures, Rinise dhe Sporteve | 1,370,500 | 316,900 | 1,687,400 |
| 13 | Ministria e Shendetesise | 16,985,015 | 1,868,290 | 18,853,305 |
| 14 | Ministria e Drejtesise | 2,413,542 | 1,147,208 | 3,560,750 |
| 15 | Ministria e Puneve te Jashtme | 1,441,000 | 20,000 | 1,461,000 |
| 16 | Ministria e Brendshme | 11,942,909 | 1,215,204 | 13,158,113 |
| 17 | Ministria e Mbrojtjes | 12,946,832 | 1,134,238 | 14,081,070 |
| 18 | Sherbimi Informativ Shteteror | 1,020,783 | 14,217 | 1,035,000 |
| 19 | Drejtoria e Radio Televizionit | 300,000 | 0 | 300,000 |
| 20 | Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave | 144,000 | 8,000 | 152,000 |
| 21 | Drejtoria e Rezervave te Shtetit | 110,000 | 5,000 | 115,000 |
| 22 | Akademia e Shkences | 575,000 | 37,000 | 612,000 |
| 24 | Kontrolli Larte i Shtetit | 235,000 | 0 | 235,000 |
| 25 | Ministria e Punes, Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta | 31,779,800 | 445,400 | 32,225,200 |
| 26 | Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave | 984,800 | 575,886 | 1,560,686 |
| 27 | Agjensia Kombetare e Privatizimit | 27,000 | 3,000 | 30,000 |
| 28 | Prokuroria e Pergjithshme | 976,000 | 3,000 | 979,000 |
| 29 | Zyra e Administrimit te Buxhetit Gjyqesor | 1,233,500 | 500 | 1,234,000 |
| 30 | Gjykata Kushtetuese | 75,000 | 0 | 75,000 |
| 31 | Agjensia Telegrafike Shqiptare | 85,000 | 7,000 | 92,000 |
| 35 | Drejtoria e Pergjithshme e Doganave | 829,000 | 337,200 | 1,166,200 |
| 37 | Drejtoria e Pergjithshme e Standartizimit | 26,300 | 700 | 27,000 |
| 40 | Partite Politike | 200,000 | 0 | 200,000 |
| 41 | Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve | 1,159,200 | 421,900 | 1,581,100 |
| 48 | Drejtoria e Metrologise dhe Kalibrimit | 23,000 | 0 | 23,000 |
| 50 | Instituti Statistikes | 118,800 | 8,000 | 126,800 |
| 53 | Komisioni i Letrave me Vlere | 22,000 | 1,000 | 23,000 |
| 55 | Shkolla e Magjistratures | 50,600 | 900 | 51,500 |
| 56 | Fondi i Zhvillimit Shqiptar | 545,000 | 1,694,567 | 2,239,567 |
| 57 | Qendra Kombetare e Kinematografise | 81,700 | 600 | 82,300 |
| 59 | Instituti i Integrimit te Perndjekurve Politik | 24,900 | 0 | 24,900 |
| 63 | Keshilli i Larte i Drejtesise | 76,886 | 0 | 76,886 |
| 66 | Avokati i Popullit | 72,000 | 0 | 72,000 |
| 67 | Komisioni i Sherbimit Civil | 36,100 | 0 | 36,100 |
| 73 | Komisioni Qendror i Zgjedhjeve | 510,800 | 0 | 510,800 |
| 75 | Avokati i Shtetit | 72,000 | 0 | 72,000 |
| 76 | Inspektoriati i Larte Kontrollit te Deklarimit te Pasurive | 79,000 | 0 | 79,000 |
| 77 | Autoriteti i Konkurences | 34,000 | 0 | 34,000 |
| 78 | Ministria e Integrimit | 84,296 | 3,125 | 87,421 |
| 79 | Komiteti Shteteror i Kthimit dhe Kompensimit te Pronave | 495,000 | 0 | 495,000 |
| 82 | Keshilli Kombetar Kontabilitetit | 9,300 | 700 | 10,000 |
| 83 | Drejtoria e Pergjithshme e Parandalimit te Pastrimit | 43,000 | 0 | 43,000 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | te Parave | | | |
| 84 | Inspektorati i Instituteve Private te Pensioneve Suplementare | 10,000 | 0 | 10,000 |
| | **Totali** | **146,647,423** | **25,357,115** | **172,004,538** |

Ta.1.1 **ne 000 Lek**

| **Kodmin** | **Institucionet e Pavarura** | **Nr. Punonjesve** | **Paga 600+601** | **Buxheti Total** |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Presidenca | 66 | 64,000 | 144,000 |
| 2 | Kuvendi | 414 | 442,000 | 897,000 |
| 24 | Kontrolli Larte i Shtetit | 160 | 185,000 | 235,000 |
| 28 | Prokuroria e Pergjithshme | 800 | 785,000 | 979,000 |
| 29 | Zyra e Administrimit Buxhetit Gjyqesor | 1,230 | 940,000 | 1,234,000 |
| 30 | Gjykata Kushtetuese | 45 | 52,500 | 75,000 |
| 53 | Komisioni i Letrave me Vlera | 15 | 0 | 23,000 |
| 55 | Shkolla e Magjistratures | 22 | 19,500 | 51,500 |
| 63 | Keshilli i Larte i Drejtesise | 48 | 57,000 | 76,886 |
| 66 | Avokati i Popullit | 45 | 50,000 | 72,000 |
| 67 | Komisioni i Sherbimit Civil | 28 | 31,900 | 36,100 |
| 73 | Komisioni Qendror i Zgjedhjeve | 60 | 68,500 | 510,800 |
| 76 | Inspektoriati i Larte Kontrollit te Deklarimit te Pasurive | 35 | 50,000 | 79,000 |
| 77 | Autoriteti i Konkurences | 20 | 22,000 | 34,000 |
| 79 | Komiteti Shteteror i Kthimit dhe Kompensimit te Pronave | 160 | 150,000 | 495,000 |
| | | | | |

Tab.2 **ne 000 Lek**

| **Kod min** | **Investimet e vitit 2006 sipas Ministrive dhe Institucioneve (ne 000 Lek)** | **Nga Buxheti** | **Nga te Ardhur at** | **Financim i Huaj** | **Totali** |
|---|---|---|---|---|---|
| **1** | **Presidenca** | **20,000** | **0** | **0** | **20,000** |
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 20,000 | 0 | 0 | 20,000 |
| **2** | **Kuvendi** | **175,000** | **0** | **0** | **175,000** |
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 175,000 | 0 | 0 | 175,000 |
| **3** | **Keshilli Ministrave** | **162,400** | **0** | **495,000** | **657,400** |
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 75,000 | 0 | 0 | 75,000 |
| 012 | Administrata Publike | 87,400 | 0 | 495,000 | 582,400 |
| **4** | **Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes** | **361,800** | **7,200** | **3,575,000** | **3,944,000** |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 55,300 | 2,000 | 1,275,000 | 1,332,300 |
| 092 | Mbeshtetje per Energjine | 15,000 | 5,000 | 2,300,000 | 2,320,000 |
| 113 | Mbesht. Gjeoshkenc e te tjera | 210,000 | 200 | 0 | 210,200 |
| 114 | Mbesht. Miniera e Nd/je Publike | 80,000 | 0 | 0 | 80,000 |
| 133 | Mbeshtetje e Zhvill. Ekonomik | 1,500 | 0 | 0 | 1,500 |
| **5** | **Ministria e Bujqesise, Ushqimit dhe Mrojtjes se Konsumatorit** | **1,231,934** | **23,200** | **1,715,500** | **2,970,634** |
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 7,000 | 0 | 0 | 7,000 |
| 102 | Sherbimet e Insp. Bujq. Sig Ushq. e Mbr. Konsum. | 37,500 | 2,000 | 222,000 | 261,500 |
| 104 | Infrastruktura e Ujitjes dhe Kullimit | 821,154 | 20,500 | 1,102,500 | 1,944,154 |
| 105 | Mbesh.e prodh. Bujq, blek, agroind, dhe market. | 301,280 | 0 | 383,000 | 684,280 |
| 106 | Kerkimi dhe Ekstensioni | 10,000 | 700 | 0 | 10,700 |
| 107 | Menaxhimi i burimeve natyrore | 50,000 | 0 | 0 | 50,000 |
| 108 | Zhvillimi i Integruar Rural | 5,000 | 0 | 8,000 | 13,000 |
| **6** | **Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit** | **23,956,810** | **14,190** | **7,146,500** | **31,117,500** |
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 15,000 | 0 | 0 | 15,000 |
| 122 | Rrjeti i rrugeve nacionale | 19,638,484 | 0 | 3,621,000 | 23,259,484 |
| 123 | Manaxhimi I Transportit Rrugor | 14,460 | 1,500 | 0 | 15,960 |
| 124 | Portet | 254,430 | 0 | 500,000 | 754,430 |
| 125 | Hekurudhat | 226,000 | 0 | 0 | 226,000 |
| 126 | Aviacioni Civil | 61,200 | 0 | 0 | 61,200 |
| 077 | Ujesjelles Kanalizime | 2,648,286 | 12,690 | 2,697,900 | 5,358,876 |
| 078 | Strehimi dhe Urbanistika | 612,950 | 0 | 327,600 | 940,550 |
| 139 | Infrastruktura Turisitke | 486,000 | 0 | 0 | 486,000 |
| 070 | Sherbimet publike | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **9** | **Regjistrimi i Pasurive te Paluajtshme** | **0** | **100,000** | **0** | **100,000** |
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 0 | 100,000 | 0 | 100,000 |
| **10** | **Ministria e Financave** | **68,000** | **0** | **20,960** | **88,960** |
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 68,000 | 0 | 20,960 | 88,960 |
| 012 | Zbatimi i Vendimeve Gjyqesore | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 013 | Pagesa te menjehershme | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 014 | Mbeshtetje e Institucioneve Financiare | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **11** | **Ministria e Arsimit dhe Shkences** | **2,921,309** | **610,000** | **1,218,000** | **4,749,309** |
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 60,500 | 4,000 | 50,000 | 114,500 |
| 042 | Arsimi Baze (perfshire parashkollorin) | 1,566,309 | 0 | 658,000 | 2,224,309 |
| 043 | Arsimi i Mesem (i pergjithshem) | 635,000 | 0 | 350,000 | 985,000 |
| 044 | Arsimi i Mesem (profesional) | 362,500 | 4,000 | 90,000 | 456,500 |
| 045 | Arsimi Universitar | 192,000 | 600,000 | 70,000 | 862,000 |
| 046 | Programet Ars. dhe Trainimi i Mesuesve | 5,000 | 2,000 | 0 | 7,000 |
| 047 | Fonde per Shkencen | 100,000 | 0 | 0 | 100,000 |
| **12** | **Ministria e Turizmit, Kultures, Rinise dhe Sporteve** | **415,300** | **22,000** | **237,000** | **674,300** |
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 14,000 | 1,000 | 0 | 15,000 |
| 082 | Trashegimia Kulturore, Muzete, Bibliotekat | 216,897 | 10,000 | 0 | 226,897 |
| 083 | Arti dhe Kultura | 98,693 | 4,000 | 237,000 | 339,693 |
| 084 | Zhvillimi i Sportit | 79,747 | 0 | 0 | 79,747 |
| 085 | Programe specifike kulturore dhe te turizmit | 5,963 | 7,000 | 0 | 12,963 |
| **13** | **Ministria e Shendetesise** | **1,872,305** | **53,000** | **1,480,000** | **3,405,305** |
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 40,170 | 7,000 | 0 | 47,170 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 052 | Sherbimet e Kujdesit Paresor | 418,033 | 11,000 | 385,000 | 814,033 |
| 053 | Sherbimet e Kujdesit Dytesor | 1,386,002 | 25,000 | 1,095,000 | 2,506,002 |
| 055 | Sherbimet e Shendetit Publik | 28,100 | 10,000 | 0 | 38,100 |
| **14** | **Ministria e Drejtesise** | **403,500** | **1,500** | **1,125,750** | **1,530,750** |
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 94,200 | 0 | 528,750 | 622,950 |
| 012 | Publikimet Zyrtare | 300 | 0 | 42,500 | 42,800 |
| 013 | Mjekesia Ligjore | 8,000 | 0 | 0 | 8,000 |
| 034 | Drejtoria e Pergjithshme e Burgjeve | 298,000 | 0 | 554,500 | 852,500 |
| 015 | Sherbimi i Permbarimit Gjyqesor | 3,000 | 0 | 0 | 3,000 |
| 016 | Sherbimet per çeshtjet e biresimeve | 0 | 1,500 | 0 | 1,500 |
| **15** | **Ministria e Puneve te Jashtme** | **90,000** | **0** | **0** | **90,000** |
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 5,000 | 0 | 0 | 5,000 |
| 012 | Perfaqesite Diplomatike | 85,000 | 0 | 0 | 85,000 |
| **16** | **Ministria e Brendshme** | **302,146** | **199,854** | **531,250** | **1,033,250** |
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 49,238 | 0 | 0 | 49,238 |
| 042 | Arsimi dhe Shkenca (Akademia) | 0 | 8,054 | 0 | 8,054 |
| 083 | Kulture dhe Sport | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 034 | Policia e Shtetit | 180,606 | 181,300 | 491,250 | 853,156 |
| 035 | Garda e Republikes | 22,302 | 0 | 0 | 22,302 |
| 016 | Prefekturat dhe Funksionet e Deleguara te P. Vendor | 10,000 | 500 | 0 | 10,500 |
| 017 | Gjendja Civile ne Prefektura dhe Keshillat Lokale | 30,000 | 0 | 0 | 30,000 |
| 038 | Policia e Mbrojtjes nga Zjarri (M.N.Z.) | 10,000 | 10,000 | 0 | 20,000 |
| 129 | Mbeshtetje per infrastrukturen urbane dhe rurale | 0 | 0 | 40,000 | 40,000 |
| 140 | Emergjencat | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **17** | **Ministria e Mbrojtjes** | **1,686,682** | **625,388** | **0** | **2,312,070** |
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 0 | 15,000 | 0 | 15,000 |
| 022 | Sigurimi i Mbrojtjes | 1,527,019 | 556,677 | 0 | 2,083,696 |
| 043 | Arsimi | 158,394 | 0 | 0 | 158,394 |
| 054 | Shendetesia | 0 | 51,200 | 0 | 51,200 |
| 085 | Kulture e Sport | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 026 | Mbesht.teknike e pune shkencore | 1,269 | 2,511 | 0 | 3,780 |
| 067 | Mbeshtetje Sociale per Ushtaraket | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **18** | **Sherbimi Informativ Shteteror** | **19,935** | **65** | **0** | **20,000** |
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 16,818 | 0 | 0 | 16,818 |
| 042 | Arsimi | 3,117 | 65 | 0 | 3,182 |
| **19** | **Drejtoria e Radio Televizionit** | **0** | **0** | **0** | **0** |
| 081 | Sherbimet per shqiptaret jashte kufirit dhe sherbimi per te huajt ne gjuhe huaj + Sateliti | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 082 | Projekte teknike per futjen e teknologjive te reja | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 083 | Prodhime filmike ose veprimtari artistike mbarekombetare | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 084 | Orkestra Simfonike e RTSH dhe Kinematografise | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **20** | **Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave** | **59,000** | **1,000** | **0** | **60,000** |
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 59,000 | 1,000 | 0 | 60,000 |
| **21** | **Drejtoria e Rezervave te Shtetit** | **0** | **5,000** | **0** | **5,000** |
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 0 | 5,000 | 0 | 5,000 |
| **22** | **Akademia e Shkences** | **52,000** | **8,000** | **10,000** | **70,000** |
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 52,000 | 8,000 | 10,000 | 70,000 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **24** | **Kontrolli Larte i Shtetit** | **15,000** | **0** | **0** | **15,000** |
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 15,000 | 0 | 0 | 15,000 |
| **25** | **Ministria e Punes, Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta** | **240,900** | **6,300** | **431,000** | **678,200** |
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 42,000 | 1,000 | 0 | 43,000 |
| 062 | Sigurimi Shoqeror | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 063 | Mbrojtja Sociale | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 064 | Sherbimet e Kujdesit Social | 132,800 | 300 | 431,000 | 564,100 |
| 065 | Sherbimet e Punesimit | 66,100 | 5,000 | 0 | 71,100 |
| **26** | **Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave** | **183,420** | **135,580** | **438,686** | **757,686** |
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 15,000 | 1,080 | 0 | 16,080 |
| 072 | Programe per mbrojtjen e Mjedisit | 23,260 | 0 | 183,186 | 206,446 |
| 103 | Mbeshtetje per Peshkimin | 38,500 | 0 | 107,500 | 146,000 |
| 104 | Administrimi i Ujrave | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 105 | Administrimi i Pyjeve | 106,660 | 134,500 | 148,000 | 389,160 |
| **27** | **Agjensia Kombetare e Privatizimit** | **0** | **0** | **0** | **0** |
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **28** | **Prokuroria e Pergjithshme** | **59,000** | **1,000** | **0** | **60,000** |
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 59,000 | 1,000 | 0 | 60,000 |
| **29** | **Zyra e Administrimit Buxhetit Gjygjsor** | **99,900** | **100** | **0** | **100,000** |
| 031 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 99,900 | 100 | 0 | 100,000 |
| **30** | **Gjykata Kushtetuese** | **2,500** | **0** | **0** | **2,500** |
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 2,500 | 0 | 0 | 2,500 |
| **31** | **Agjensia Telegrafike Shqiptare** | **10,000** | **2,000** | **0** | **12,000** |
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 10,000 | 2,000 | 0 | 12,000 |
| **35** | **Drejtoria e Pergjithshme e Doganave** | **0** | **166,200** | **0** | **166,200** |
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 0 | 166,200 | 0 | 166,200 |
| **37** | **Drejtoria e Pergjithshme e Standartizimit** | **1,800** | **200** | **0** | **2,000** |
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 1,800 | 200 | 0 | 2,000 |
| **40** | **Partite Politike** | **0** | **0** | **0** | **0** |
| **41** | **Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve** | **0** | **127,900** | **0** | **127,900** |
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 0 | 127,900 | 0 | 127,900 |
| **48** | **Drejtoria e Metrologjise dhe Kalibrimit** | **5,000** | **0** | **0** | **5,000** |
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 5,000 | 0 | 0 | 5,000 |
| **50** | **Instituti Statistikes** | **2,000** | **0** | **0** | **2,000** |
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 2,000 | 0 | 0 | 2,000 |
| 012 | Projekti Repoba (rregj i Pop.e Banesave) | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **53** | **Komisioni i Letrave me Vlera** | **1,000** | **1,000** | **0** | **2,000** |
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 1,000 | 1,000 | 0 | 2,000 |
| **55** | **Shkolla e Magjistratures** | **3,000** | **0** | **0** | **3,000** |
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 3,000 | 0 | 0 | 3,000 |
| **56** | **Fondi i Zhvillimit Shqiptar** | **545,000** | **0** | **1,694,567** | **2,239,567** |
| 071 | Programe Zhvillimi | 545,000 | 0 | 1,694,567 | 2,239,567 |
| **57** | **Qendra Kombetare e Kinematografise** | **2,000** | **0** | **0** | **2,000** |
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 2,000 | 0 | 0 | 2,000 |
| **59** | **Instituti I Integrimit te Perndjekurve Politik** | **2,000** | **0** | **0** | **2,000** |
| 011 | Rehabilitimi i te Perndjekurve Politik | 2,000 | 0 | 0 | 2,000 |
| **63** | **Keshilli i Larte i Drejtesise** | **4,886** | **0** | **0** | **4,886** |
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 4,886 | 0 | 0 | 4,886 |
| **66** | **Avokati i Popullit** | **5,000** | **0** | **0** | **5,000** |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 5,000 | 0 | 0 | 5,000 |
| **67** | **Komisioni i Sherbimit Civil** | **500** | **0** | **0** | **500** |
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 500 | 0 | 0 | 500 |
| **73** | **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve** | **6,300** | **0** | **0** | **6,300** |
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 6,300 | 0 | 0 | 6,300 |
| 012 | Zgjedhjet e pergjithshme dhe lokale | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **75** | **Avokati i Shtetit** | **4,000** | **0** | **0** | **4,000** |
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 4,000 | 0 | 0 | 4,000 |
| **76** | **Inspektoriati i Larte Kontrollit te Deklarimit te Pasurive** | **7,000** | **0** | **0** | **7,000** |
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 7,000 | 0 | 0 | 7,000 |
| **77** | **Autoriteti i Konkurences** | **2,000** | **0** | **0** | **2,000** |
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 2,000 | 0 | 0 | 2,000 |
| **78** | **Ministria e Integrimit** | **10,040** | **0** | **3,125** | **13,165** |
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 10,040 | 0 | 3,125 | 13,165 |
| **79** | **Komiteti Shteteror i Kthimit dhe Kompensimit te Pronave** | **17,000** | **0** | **0** | **17,000** |
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 17,000 | 0 | | 17,000 |
| **82** | **Keshilli Kombetar Kontabilitetit** | **0** | **0** | **0** | **0** |
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **83** | **Drejtoria e Pergjithshme e Parandalimit te Pastrimit te Parave** | **3,000** | **0** | **0** | **3,000** |
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 3,000 | 0 | 0 | 3,000 |
| **84** | **Inspektorati i Instituteve Private te Pensioneve Suplementare** | **0** | **0** | **0** | **0** |
| 011 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | **Totali** | **35,030,367** | **2,110,677** | **20,122,338** | **57,263,382** |

**VENDIM**
**Nr.805, datë 6.12.2006**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.527, DATË 2.8.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË TRE ANËTARËVE TË ENTIT RREGULLATOR TË UJIT (ERRU)"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 4 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit e të përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.527, datë 2.8.2006 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Në titull shprehja "...tre anëtarëve të Entit Rregullator të Ujit (ERRU)…" zëvendësohet me ". . .tre anëtarëve të komisionit kombëtar rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit e të përpunimit të ujërave të ndotura...".

2. Në paragrafin e parë të tekstit bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Shprehja "Emërimin anëtarë të Entit Rregullator të Ujit…" zëvendësohet me "Emërimin anëtarë të komisionit kombëtar rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit e të përpunimit të ujërave të ndotura…".

b) Shprehja "...të përzgjedhura nga Komisioni Kombëtar i Ujit…", zëvendësohet me "…të përzgjedhura nga ekipi përzgjedhës,...".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.807, datë 6.12.2006**

**PËR RISTRUKTURIMIN E INSTITUTIT TË STUDIMEVE DHE PROJEKTIMEVE TË INDUSTRISË SË LEHTË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13 të ligjit nr.7893, datë 22.12.1994 "Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ristrukturimin e Institutit të Studimeve dhe Projektimeve të Industrisë së Lehtë dhe përfshirjen e tij në Inspektoratin Qendror Teknik (IQT).

2. Buxheti i miratuar për vitin 2006, për Institutin e Studimeve dhe Projektimeve të Industrisë së Lehtë, i kalon IQT-së.

3. Punonjësit, që do të dalin të papunë nga ky ristrukturim, të trajtohen nga buxheti i IQT-së, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Vendimi nr.348, datë 29.9.1990 i Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Institutit të Studimeve dhe Projektimeve të Industrisë së Lehtë", shfuqizohet.

5. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.814, datë 15.12.2006**

**PËR ASISTENCËN EKONOMIKE TË MENJËHERSHME PËR PERSONAT QË PËRFITOJNË PENSION**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "ç" të nenit 66 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfitojnë asistencë të menjëhershme, në shumën 5 000 (pesë mijë) lekë:

a) personat, që marrin pension pleqërie, pension invaliditeti dhe pension familjar, sipas ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë" dhe nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

b) veteranët e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare që trajtohen me shpërblim mujor, sipas ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 "Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar", dhe personat që marrin pension për merita të veçanta, sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë", të cilët nuk përfitojnë pension pleqërie, invaliditeti apo familjar;

c) pensionistët, që marrin pension, sipas ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë" dhe sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

c) personat, që marrin trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr.8685, datë 22.6.2000 "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera në nëntokë", si dhe personat, që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr.9179, datë 29.1.2004 "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake".

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përllogariten në shumën 2 668 000 000 (dy miliardë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë milionë) lekë dhe të përballohen, si më poshtë vijon:

a) 800 000 000 (tetëqind milionë) lekë nga kursimet e shërbimit të borxhit të brendshëm;

b) 811 000 000 (tetëqind e njëmbëdhjetë milionë) lekë nga kursimi i shpenzimeve korrente në institucionet buxhetore, që rezultojnë në fund të vitit 2006;

c) 1 057 000 000 (një miliard e pesëdhjetë e shtatë milionë) lekë nga pakësimi i subvencioneve të Buxhetit të Shtetit, për buxhetin e sigurimeve shoqërore, si pasojë e tejkalimit të të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

3. Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta t'i shtohet, në buxhetin e miratuar për vitin 2006, shuma 1 611 000 000 (një miliard e gjashtëqind e njëmbëdhjetë milionë) lekë.

4. Në programin "Mbrojtja sociale", të miratuar në buxhetin e vitit 2006, të shtohet shuma 2 668 000 000 (dy miliardë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë milionë) lekë, që të përdoret:

a) për asistencën e menjëhershme të pensionistëve, 2 647 425 000 (dy miliardë e gjashtëqind e dyzet e shtatë milionë e katëqind e njëzet e pesë mijë) lekë;

b) për pagesën e komisioneve të shërbimit të pagesave dhe shpenzimeve administrative, 20 575 000 (njëzet milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë.

5. Procedurat e pagesës së asistencës së menjëhershme për pensionistët të realizohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare sh.a.

6. Ngarkohen Ministria e Financave, ministritë e linjës dhe të gjitha institucionet qendrore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.815, datë 15.12.2006**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.434, DATË 28.6.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR FONDIN E VEÇANTË NË INSTITUCIONET BUXHETORE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë", të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006", të nenit 18 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 4 e vendimit nr.434, datë 28.6.2006 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"4. Përjashtimisht për vitin 2006, masa e shpërblimit e çdo punonjësi këtë fund viti të jetë deri 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë.

Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi i veçantë, i miratuar për vitin 2006.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare**
**ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare,** në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”,
prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

## BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. **KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
2. **KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
3. **REGJISTRAT E NOTERISË**
4. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**

| | | |
|---|---|---|
| 1. | **PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006)…………………………………………….................** | **1500** |
| 2. | **PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) ……………………………………….....................** | **600** |
| 3. | **PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)................** | **1300** |
| 4. | **PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT……….............** | **500** |

## Botime të reja

| | | |
|---|---|---|
| 1 | **TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)…......….......** | **1000** |
| 2 | **TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)…......…......** | **500** |
| 3 | **TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)…………….…......** | **1000** |
| 4 | **TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)…………..…......** | **500** |
| 5 | **PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDERKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË…………………………………………..........................................** | **1000** |
| 6 | **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR………………….** | **800** |
| 7 | **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET……………….....….......** | **500** |
| 8 | **PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006)………………………………………………………………………………………** | **1000** |
| 9 | **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQERITË TREGTARE……..........** | **500** |

Hyri në shtyp më 19.12.2006
Doli nga shtypi më 19.12.2006

| | |
|---|---|
| Tirazhi: 4000 copë | Formati: 60x88/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2006

Çmimi 100 lekë